

# **RAPORT VJETOR ZMR**

## **2007**

**JANAR 2008**

Mbrojtja nga rrezatimet e populates dhe mjedisit ne Shqiperi eshte nje process ne vazhdimesi I cili kerkon nje pune ntensive dhe te kualifikuar te specialisteve te Zyres per Mbrojtjen nga Rrezatimet .Jam I kenaqur qe stafi I ZMR ka punuar ne menyre te palodhur si cdo vit ne zbatim te te funksionve qe jep ligji per mbrojtjen nga rrezatimet ku misioni kryesor ka qene te perpunoje dokumentat legale per mbrojtjen e punonjesve dhe publikut nga efektet negative te rezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sitemin e administrimit dhe kontrollit te mbrojtjes nga rrezatimet I cili siguron mbrojtjen e publikut dhe mjedisit ne perputhje dhe me standartet nderkombetare si te ANEA dhe EU.Megjithe problemet e hasura puna ne ZMR gjate vitit 2007 ka ardhur ne ngritje dhe problematika per mbrojtjen nga rrezatimet ka ardhur ne renie.

Ky raport paraqet punen e bere nga ZMR dhe KMR per realizmient e vitit 2007 si me poshte vijon.

### **Licencimi**

Gjate vitit 2007ka vazhdur normalisht procesi I licencimit te perdoruesve te burimev te rezatimit jonizues si nje nga detyrat kryesore te ZMr dhe KMR.Ne kete kuader jane leshur nje numer licencash si per burime te mbyllura dhe gjeneratore me reze x.Kjo eshte bere ne perputhje me aplikimet per licence dhe ajo qe dueht theksuar eshte ndarja e detyrave ne ZMR qe nga procesi I dorezimit te dokumentacionit deri ne leshime e licences nga ana e zmr.Ky eshte nje process I cili kalon ne vlersim nga ana e nspektorev deri ne pergatitjen e raportit vleresuas.Aktualisht ZMR mbulon me ekspertize subjektet private por persa I takon subjekteve shteterore ato akoma nuk jane mbuluar me ekspertize nag ana e IFB.Nje element I rendesishem ka qene kontrolli perfundimtar me dokumentin vleresues ne perfundim te procesit.

Gjate vitit 2007 kane aplikuar prane ZMR 20 subjekte per license, te cilat pasi kane plotesuar te gjitha pikat sipas kerkeses per license jane miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet .


Numri i subjekteve te licensuara gjate 2007 te cilet kane ne perdorin gjeneratore te rrezatimit jonizues eshte 15.Jane licensuar 3 subjekte te cilet perdorin burime radioactive te mbyllura te kategorise 4 qe operojne ne fushen e industrise , gjithashtu eshte licensuar 1 qender e cila ka ne perdorim burim radioaktiv te kategorise 1 ne fushen e mjekesise si dhe 1 license per perdorim te lendeve radioactive te hapura per ekzaminime .

Per sa i takon vitit 2007, licensimi eshte i perqendruar me shume ne sektorin privat, ndersa ne sektorit shteteror megjithe angazhimin e ZMR ka pasur probleme dhe gjate vitit 2007 u jane derguar disa here letra zyrtare DShP te prefekturave kryesore nga ZMR si dhe nga Kabineti i Ministrit te

Shendetesise perseri keto qendra nuk kane plotesuar dokumentacionin per licensim ose eshte plotesuar pjeserisht, pervec qendres Spitalore te qytetit te Elbasanit e cila ka plotesuar te gjithe proceduren per licensim, por nuk eshte pajisur me license nga KMR sepse nuk eshte realizuar ekspertiza nga IFB. Ne baze te vendimit te marre ne mbledhjen e KMR, vendim i cili ngarkon kete institucion per kryerjen e ekspertizes per subjektet shteterore. Gjate vitit 2007 eshte licensuar nga KMR vetem nje subject shteteror, Qendra e Radioterapise ne Qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza” . Megjithe perpjekjen e ZMR per te plotesuar dokumentacionin kjo qender ka nje problematike shume kompekse .Nje problem i hasur gjate vitit 2007 ka qene paqartesia e subjekteve fizike ose juridike ne plotesimin e dokumentacionit dhe per kete arsye procedura per licensimin e tyre shpeshhere zgjatet. Gjithashtu nje problematike tjeter eshte dhe mosparaqitja e subjekteteve juridike ose fizike prane ZMR nje muaj para afatit te skadimit te licenses , sipas nenit 4 te Rregullores per licensim dhe inspektim te veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues, po keshtu gjate 2007 ka pasur subjekte te cilat kane plotesuar dokumentacionin dhe licensa eshte miratuar nga KMR nuk jane paraqitur per ta terhequr ate.Per problematiken e mesiperme mendojme se KMR duhet te mbaje nje qendrim ndaj ketyre subjekteve dhe domosdoshmerisht duhet te fuqizohet sistemi i gjobave gje qe gjate vitit 2008 do te shoqerohet me miratimin e dokumentit per gjobat. Me poshte po paraqesim nje shperndarje e licensave te miratuara nga KMR me tabelen 1 dhe grafikun 1 :


Tab.1

Nr.i licensave	Gjeneratore me rreze X	Burime te mbyllura Radioaktive(kat.1 ,2,3,4,5)	Burime te hapura Radioaktive	Imort-eksport	Transport
20	15 licensa	3 licensa (burime te kategorise4) 1 license(burim i kat 1)	1 license	-----	-----




Grafik nr.1

Ne grafikun nr.2 jepet perqendrimi i licensimit ne sektorin privat dhe ate shteteror.



Grafik nr2

Grafiku nr.3 na jep numrin e aparaturave me rreze X te licensuara ne vitin 2007.



Grafik nr 3

## 2-Import-Ekporti dhe Transporti ne 2007

### -Import-eksporti

Per sa i takon import-eksportit te materialeve radioactive dhe gjeneratoreve me rreze x gjate 2007 jane dhene 51 leje importi , nga te cilat 27 jane leje importi per lende radioactive te hapura I-131 dhe Tc-99 te cilat perdoren ne mjekesine berthamore per ekzaminime “in Vivo”, 11 leje importi lende radioactive I-125 per ekzaminime “in Vitro” ,2 leje importi Tc-99 mjekesia berthamore QSUT( e cila nuk do te mbeshtet ne te ardhmen me leje sepse nuk ka licence per perdorim burime te hapura),6 leje importi per Gjeneratore te rrezatimit X ,1 leje importi per burim te mbullur radioaktiv I-192 i kat 2, 1 leje importi burim i mbyllur Co-60 i kat.4 i cili nuk eshte importuar ende per arsye teknike te kompanise dhe 3 leje importi per solucione standarte te cilat perdoren ne IFB per analiza kimike. Subjektet te cilet kane ne perdorim lendet e mesiperme jane pajisur me leje importi duke zbatuar te gjitha procedurat per import-eksportet duke u bazuar ne udhezuesin mbi import-eksportet e materialeve radioactive Nr.4756/1 dt.21/12/2006 dhe kategorizimit te burimeve radioactive nr.4756/2 dt.21/12/2006 ,te cilat jane miratuar nga KMR .Gjate vitit 2007


Qendra e Radioterapise ne QSUT do te importonte nje burim te fuqishem Co-60 , burim i kategorise se pare . Kjo qender ka plotesuar te gjitha proceduren per licensim dhe eshte pajisur me license nga KMR , por per importimin e ketij burimi te fuqishem duhet te plotesohen dhe procedurat per transportin te tij nga momenti i mberritjes ne kufi , procedura te cilat deri me tani nuk jane plotesuar dhe per kete arsye nuk eshte pajisur me leje importi dhe transporti nga KMR

Te gjitha subjektet qe kryejne importe jane pajisur me leje importi pasi ata kane aplikuar per license ne ZMR dhe eshte miratuar nga KMR.

Eksporte gjate 2007 nuk ka pasur.

Importet per vitin 2007 jane hedhur te gjitha ne sistemin RAIS.


Materialet radioactive dhe gjeneratoret me rreze x te importuara	I-131, Tc-99 Medicare	Tc-99 QSUT	Kite RIA Neo-style Kl. Jeta	Gjeneratore me rrezeX Medfau	Burim i kat 2 I-192 IFB	Burim i kat4 Kurum Nuk eshte importuar akoma	Solucion Standart IFB
NR i lejeve	27	2	11	6	1	1	3



Grafik nr 4

## -Transporti

Gjate vitit 2007 jane dhene 40 leje transporti. Transporti i materialeve te ndryshme radioaktive eshte kryer nga subjekte te licensuara nga KMR dhe duke zbatuar te gjitha procedurat per nje transport te sigurve te ketyrre materialeve radioaktive. Kryesisht gjate 2007 eshte transportuar lende e hapur radioactive I-131 dhe Tc-99 nga qendra Medicare , te cilat perdoren nga kjo qender ne mjekesine berthamore per ekzaminime “In Vivo” . Gjithashtu nga qendra Medicare eshte kryer ne baze te nje marreveshjeje dhe transporti per kliniken Neo-Style, e cila importon lende te hapur radioactive I-125 per ekzaminime “In Vitro” . Gjate 2007 eshte transportuar nga IFB nje burim radioaktiv I kat.2 Ir-192 , Solucione Standarte te cilat jane perdorur nga ky institucion per analiza te ndryshme laboratorike . Transportet per 2007 jane hedhur te gjitha ne sistemin RAIS.



grafik nr5


Gjate 2007 jane dhene 29 leje transporti per lende te hapur radioactive I-131 dhe Tc-99 , te cilat perdoren ne mjekesine berthamore, 7 leje transporti I-125 e cila perdoret per ekzaminime “in Vitro”, 3 leje transporti per Solucione standarte te cilat jane perdorur nga IFB per analiza kimike, 1 leje per transportin e burimit te mbyllur radioaktiv Ir-192, burim I kat 2 .

## **Ekspertizat**

Per sa i takon ekspertizes, gjate vitit 2007 jane kryer 12 ekspertiza ne kabinete te ndryshme radiologjie si dhe ne qendra te cilat disponojne dhe kane ne perdorim burime te mbyllura te kat 1 dhe 4 ose lende te hapur radioaktive . Vleresimi per mbrojtjen nga rrezatimi jonizues eshte kryer me qellim qe keto qendra te plotesojne kushtet per nje pune te sigurte , ku si publiku , personeli dhe pacienti te jene te mbrojtur nga rrezatimi. Me poshte po paraqesim me tabele numrin e ekspertizave si dhe qendrat per te cilat jane realizuar ato gjate vitit 2007 si dhe nje shperndarje grafike per ekspertizat e realizuara sipas inspektoreve te ZMR

<b>Nr</b>	<b>Subjektet</b>	<b>Burimi radioaktiv / aparatura per te cilet eshte bere vleresimi per mbrojtjen nga rrezatimi.</b>
1 I.M R.P	Onkologjik	Co-60,CT-simulator, G/S,Ir-192,aparatura e rr.X per kanc.e lek
2 I.M	Neo-Style	I-125
3 Sh.A	Coca-Cola	Am-241
4 R.P	Medicare Fier	CT-Skaner
5 I.M,L.A	Glob Diagnostic Center	Mamografise
6 I.M	Fushe-Kruje Cement Factory	Cf-252
7 Sh.A	Murat Suta Elbasan	Grafi
8 R.P , L.A	Klinika Toska Elbasan	Grafi dentare





Grafik nr 6

## Inspektimet

Inspektimet e kryera gjate vitit 2007 te cilat perbejne nje komponent te rendesishem te ZMR jane ushtruar si veprimtari e bazuar ne kerkesat e ligjit per mbrojtjen nga rrezatimet si dhe ne rregulloren mbi licenimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues.

Duke patur parasysh se subjektet te cilat do te inspektohen kane patur problematike te ndryshme per pasoje edhe qellimi i inspektimit per subjekte te ndryshme ka qene i ndryshem, dmth eshte percaktuar nga subjekti, i cili eshte inspektuar.

Gjate vitit 2007 ne pergjithesi jane ushtruar inspektime ne raportet si me poshte:

Inspektime te planifikuara: 75% te te gjitha inspektime te kryera.

Inspektime emergjence, te befasishme e tjera: 25 % te te gjitha inspektimeve te kryera


Ne total numri i inspektimeve qe jane kryer kap shifren e 40 inspektimeve. Nese e krahasojme kete numer inspektimesh me ato te vitit te kaluar, vitit 2006, te cilat kapnin shifren 22 inspektime

per gjithë vitin na rezulton se gjatë vitit 2007 janë kryer 18 inspektime me shume, dmth afersisht 35 % me shume inspektime se viti paraardhes. Ose nga 2.7 inspektime te kryera per çdo muaj gjatë vitit 2006 ne 3.3 inspektime te kryera gjatë vitit 2007 per çdo muaj. Kete rritje te inspektimeve po e paraqesim me grafikun e meposhtem.

grafik 7

Siç shikohet kemi nje rritje te ndjeshme per sa i perket sasise apo numrit te inspektimeve. Natyrisht kjo perben nje tregues pozitiv te punes se kryer gjatë vitit 2007 ne kete fushe.

Nga 40 inspektime: 30 prej tyre jane per gjeneratore te rrezeve X dhe 10 per burime te mbyllura radioactive, te cilat po i paraqesim me poshte me grafik



grafik 8

Problemi i dyte qe lidhet me inspektimet ka te beje me cilesine e inspektimeve te kryera gjate vitit 2007.

Ne kete drejtim ne pergjithesi inspektimet e kryera gjate vitit te kaluar kane qene nga ana cilesore me rentable, pasi inspektimi eshte parapregatitur me mire se me pare duke percaktuar qellimin qe perben thelbin kryesor ne inspektim, kohen me te pershtashme dhe detaje te tjera te cilat kane treguar se kjo parapergatitje eshte e domosdoshme per te kryer nje inspektim sa me eficient.

Nga ana tjetere gjate inspektimit ne subjeketet perkatese eshte rritur kerkesa e llogarise ndaj stafit te punesuar per probleme te verejtura gjate inspektimit dhe kontrollit tek ata, u jane bere sqarime per paqartesite e tyre si dhe jane percaktuar detyrat perkatese per ato mangesi te cilat jane verejtur.

Ne keto inspektime kane pasur probleme te ndryshme si ato te gjendes se aparaturave rrezatuese, kushteve te kabinetit ku zhvillohet veprimtaria, probleme te dozimetrise personale si dhe kerkesa apo parametra, te cilat ne teresine e tyre perbejne plotesimin e kushteve dhe kerkesave te ZMR per te siguruar nje mbrojte sa me te mire te punes me gjeneratoret e rrezatimeve, per personelin punonjes, pacientet dhe mjedisin per te plotesuar ne kete menyre detyren themelore te ZMR.

Gjithashtu me rendesi te vecante edhe me shume vlera ka qene inspektimet e kryera per vleresimin dhe sigurine e burimeve radioactive ne te gjithe Republiken si nje detyre e cila kryhet per cdo vit.

## **Rezultatet e Inspektimit**

1- Duke cilesuar ato qe thame me larte te cilat kane te bejne me nje rritje sasiore dhe cilesore te inspektimeve te kryera, ne pergjithesi eshte permiresuar niveli i inspektimeve te kryera gjate ketij viti, kjo edhe si pasoje e ekperiences ne rritje dhe gjithashtu pozitivisht kane ndikuar shkembimet e eksperiaceve dhe trainimet e ndryshme .

- 2- Eshte rritur ne nje fare menyre pergjegjesia e stafëve mjekësore radiologjike e cila ka ndikuar pozitivisht ne kete drejtim. Eshte vertetuar se ne rastet kur eshte bere edhe kontroll per detyrat e lena nga ana jone levizja e stafit ka qene pozitive per problemet ne fjale.
  - 3- Lidhur me rolin e inspektimit dhe rolin e inspektorit ndaj subjekteve si pasoje e rritjes se kerkeses se llogarise ndaj ketyre stafëve si dhe perfshirjes ne problemet tona edhe te Drejtuesve te Shendetit Publik te rretheve, ka sjelle nje gadishmeri dhe pergjegjesi me te madhe nga ana e tyre per permiresimin e kabinetëve radiologjike sipas kerkesave tona dhe probleme te tjera shqetsuese qe kemi hasur ne keto inspektime. Pra eshte nje levizje mund te themi positive.
  - 4- Gjithashtu eshte rritur kerkesa edhe nga ana e ketyre subjekteve per te marre mendimin paraprak dhe te kualifikuar ne ZMR per ndertimin e kabinetëve te rinj radiologjik, gje e cila gjate vitit 2007 eshte me e larte se sa nje vit me pare .
- Megjithate ne punen e kryer gjate vitit te kaluar ka dobesi e te meta te cilat po i rendisim me poshte:

- 1- Vjetërsia e disa aparateve rrezatimit jonizues (vetem ne sektorin shteteror) dhe kabinetet te pa rikonstruktuar ulin ndjeshem mbrojtjen nga rrezatimet. Keta raste zene rreth 15% te te gjitha aparateve dhe kabinetëve te inspektuara.
- 2- Mosperdorimi i mjeteve mbrojtëseve personale te verejtur gjate inspektimeve kane ndikuar negativisht per mbrojtjen nga rrezatimet, kjo eshte pare ne masen rreth 20-25%.
- 3- Mosperdorimi i dozimetrave personale gjithashtu ka ndikuar negativisht ne kete drejtim, e cila eshte ne masen rreth 30 %.
- 4- Mosrespektimi i afateve kohore dmth tejkalimi i afatit te perdorimit te licenses, edhe kjo e verejtuar ne disa raste gjate inspektimit ka rrjedhe nga fakti i mungeses se

sistemit te gjobave. Kjo gje perben shkelje nga ana e ketyre subjekteve dhe cenon punen e ZMR.

### **Nivelet e perqendrimit te radonit gjate 2007**

Per sa i takon niveleve te perqendrimit te radonit , gjate vitit 2007 jane kryer matje te perqendrimit te radonit indoor, uje dhe toke ne qytetet e meposhteme : Ballsh, Corovode, Ksamil, Korce, Tirane dhe Kruje.

Me poshte po paraqesim nje table te ketyre matjeve te cilat jane realizuar me paisje te certifikuara ne laborete te njohur ne nivel European.

Qytetet t Matjet	Ballsh	Corovode	Ksamil	Korce	Tirane	Kruje
In door	Ne norme	256-426Bq/m <sup>3</sup>	80 Bq/m <sup>3</sup>	100Bq/m <sup>3</sup>	200Bq/m <sup>3</sup>	107Bq/m <sup>3</sup>
Toke	22.5kBq/m <sup>3</sup>	30kBq/m <sup>3</sup>	70.000-100.000 Bq/m <sup>3</sup>	-----	-----	-----
Uje	2.5 Bq/l	10 Bq/l	5Bq/l	Ne norme	-----	-----

KMR ka miratuar Nivelet kufi per perqendrimin e radonit ne ndertesa ,radioberthamave ne ushqime dhe materiale te ndertimit Nr.804/1dt.16/03/2005.


Duke pare matjet e realizuara veme re se ne pergjithesi perqendrimi i radonit indoor eshte brenda normave te lejuara duke ditur se norma e lejuar per ndertesat e reja eshte 200Bq/m<sup>3</sup>, ndersa per godinat e vjetra eshte 400Bq/m<sup>3</sup>.

Per sa i takon perqendrimit te radonit ne ujin e pishem vihet re se niveli i perqendrimit eshte brenda normes se lejuar duke ditur se

perqendrimi i radonit ne ujin e pishem kur mesatarja ditore e konsumuar eshte 10m<sup>3</sup> nuk duhet ti kaloje 100Bq/l.

### Personat e licensuar dhe te monitoruar gjate 2007. Dozat mesatare vjetore

Gjate vitit 2007 numri i punonjesve te licensuar ka qene 145.



grafik nr 9

Me grafikun nr 9 kemi paraqitur nje shperndarje te numrit te punonjesve sipas subjekteve te licensuara gjate 2007, nga te cilet 38 punojne me burime te mbyllura radioactive, 1 me lende te hapur radioactive dhe 106 punojne me aparatura te rrezatimit X.

Per sa i takon monitorimit te dozimetrise personale nga Instituti i Fizikes Berthamore numri i punonjesve te monitoruar gjate 2007 eshte 237, te cilet i perkasin 25 subjekteve te ndryshme shteterore apo private , te cilet jane te angazhuar ne pune me gjeneratore te rrezatimit X, me burime te mbyllura radioactive ose me lende te hapur radioactive.Me poshte po paraqesim dozat mesatare vjetore e mujore te punonjesve.

Doza totale vjetore e punonjesve eshte 226.51mSv.

Doza mesatare mujore per punonjes per institucion eshte 0.40mSv.

Doza mesatare vjetore per institucion per punonjes eshte 1.4mSv.

### **Vendimet dhe miratimet ne mbledhjet e KMR te zhvilluara gjate 2007.**

Gjate vitit 2007 jane zhvilluar prane Ministrise se Shendetesise 5 mbledhje te KMR –se ku jane marre disa vendime te rendesishme , te cilat po i paraqesim me poshte:

Zmr pergatiti rregulloret e meposhtme te cilat jane miratuar nga KMR :

1-Rregullore mbi sigurine ndaj ekspozimeve mjekesore me burime te rrezatimit jonizues. Nr2269/1 dt.19.06.2007

2-Rregullore per mbrojtjen e punonjesve te ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues. Nr2269/2 dt.19.06.2007

3-Rregullore mbi sigurine e publikut ndaj ekspozimeve me burime te rrezatimit jonizues.2269/3 dt.19.06.2007

4-Lista I-Perjashtimet 2296/4 dt.19.06.2007

5-Lista II-Kufijte e dozave 2296/5 dt.19.06.2007

Implementimi i ketyre rregulloreve do te filloje ne 1 janar 2009

Miratimi i ndryshimeve ne ligjin “Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”06/08/2007 date 6 gusht 2007

-Miratimi i Planit te pregatitjes dhe reagimit ne rast emergjence radiologjike per KMR. ZMR dhe IFB .Nr.3896/2 dt.24.10.2007

-Urdher per uljen e tarifave te licensimit te aktiviteteve me burimeve te rrezatimit jonizues Nr.79 dt. 20/02/2007

-Urdher mbi ndertimin e kabineteve te radiologjise ne ambjentet e banimit Nr.409 dt. 26/09/2007

Gjithashtu ne mbledhjen e KMR eshte marre vendim dhe ne lidhje me ekspertizen ,e cila per kabinetet shteterore do te kryhet nga IFB , ndersa per ato private do te behet nga ZMR deri ne momentit e trajnimit te disa fizikanteve nga IFB , te cilet do te jene te afte per kryerjen e kesaj ekspertize.

KMR ka percjelle per ne KM draft vendimi per import-eksportin e materialeve radioaktive ne perputhje me udhezuesin e import-eksporteve.

Eshte miratuar aplikimi i ri per license ku jane shtuar elemente te tjere si;

-Justifikimi dhe optimizimi etj

-Dokumenti mbi destinacionin e ambjenteve , i cili duhet te jete per ushtrim aktiviteti dhe jo per banim dt.15/10/2007

-Miratimi i formatit te ri te licenses 14/06/2007

Keto jane disa nga vendimet kryesore te miratuara nga KMR gjate 2007-es.

### **Te ardhurat financiare gjate 2007.**

Te ardhurat financiare gjate 2007 nga ZMR ne llogari te Institutit te Shendetit Publik nga licensimi , lejet e importit dhe ekspertizat kane qene ne total=453 000 leke

<b>Licensa</b>	340 000leke
<b>Leje import-eksport</b>	3 900 leke
<b>Ekspertiza</b>	110 000 leke
<b>Total</b>	453 000 leke